

URDHËR
Nr. 52, datë 1.8.2024

PËR DELEGIMIN E PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 76 të Kushtetutës; të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe të neneve 7, pika 1, dhe 121 të Rregullores së Kuvendit,

URDHËROJ:

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë është autoriteti të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të institucionit, në lidhje me proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese.
2. Autorizimet për përfaqësim ligjor të Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore, kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.
3. Autorizimet për përfaqësim ligjor të Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese, kur thirret si subjekt i interesuar, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.
4. Modeli i autorizimit për përfaqësim në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
5. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor/gjykim në Gjykatën Kushtetuese bëhet nga autoriteti i përcaktuar në pikën 1 dhe në pamundësi të tij, rast pas rasti, nga personat e përcaktuar me autorizim të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm.
6. Autoriteti i përcaktuar në pikën 1, personi që do të përfaqësojë Kuvendin, autorizohet për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin/rekursin në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile/penale/gjyqësimit në Gjykatën Kushtetuese.
7. Përfaqësimi i Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore/Gjykatën Kushtetuese, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislati në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në të gjitha nivelet përkatëse të gjyqësimit.
8. Urdhri nr. 7, datë 27.9.2021, “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë”, shfuqizohet.
9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Elisa Spiropali



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

NR. ____ prot. (vendndodhja), më ____ . ____ 2024

LIDHJA 1

AUTORIZIM

**Për përfaqësimin në çështjen/administrative/civile/penale
dhe në Gjykatën Kushtetuese**

Paditës/Kërkues _____

I paditur/subjekt i interesuar _____

Objekt _____

Në mbështetje të neneve 64 -77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe urdhrin të Kryetares së Kuvendit nr.____, datë ____ . ____ 2024 “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë”.

VENDOSA

Autorizimin e z/znj _____, me detyrë _____,
Për të përfaqësuar Kuvendin e Shqipërisë në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative, civile, penale, gjykim në Gjykatën Kushtetuese me objektin e sipërcituar deri në shpalljen e vendimit në (gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve përkatëse)/Gjykatën Kushtetuese.

SEKRETARI PËRÇJUTSHËM